



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

BOTIM I KUVËNDIT POPULLOR

Nr.15

1994

Nëntor

PËRMBAJTJA

	<i>Faqe</i>
<i>Ligj nr.7856 datë 21.9.1994</i>	<i>Për ratifikimin e "Traktatit të mirëkuptimit, bashkëpunimit dhe fqinjësisë së mirë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Rumanisë". 683</i>
<i>Ligj nr.7857 datë 21.9.1994</i>	<i>Për ratifikimin e "Konventës ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Rumanisë për eliminimin e tatimeve të dyfishta..." 683</i>
<i>Ligj nr.7858 datë 21.9.1994</i>	<i>Për ratifikimin e "Marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Turqisë për shmangien e tatimeve të dyfishta..." 684</i>
<i>Ligj nr.7859 datë 28.9.1994</i>	<i>Për miratimin e dekretit nr.915, datë 5.9.1994..... 685</i>
<i>Ligj nr.7860 datë 28.9.1994</i>	<i>Për një ndryshim në ligjin nr.7805, datë 16.3.1994 "Për tatimin mbi pasurinë në Republikën e Shqipërisë"..... 685</i>
<i>Ligj nr.7861 datë 28.9.1994</i>	<i>Për miratimin e dekretit nr.913, datë 25.8.1994..... 686</i>

<i>Ligj nr.7862</i> <i>datë 28.9.1994</i>	<i>Për miratimin e dekretit nr.919, datë 16.9.1994.....</i>	<i>687</i>
<i>Ligj nr.7863</i> <i>datë 28.9.1994</i>	<i>Për ratifikimin e "Marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Çeke për nxitjen dhe mbrojtjen reciproke të investimeve"</i>	<i>687</i>
<i>Ligj nr.7864.</i> <i>datë 29.9.1994</i>	<i>Për Kryqin e Kuq Shqiptar.....</i>	<i>688</i>
<i>Ligj nr.7865</i> <i>datë 29.9.1994</i>	<i>Për mbrojtjen e emblemës dhe të emrit të Kryqit të Kuq.....</i>	<i>690</i>
<i>Ligj nr.7867</i> <i>datë 12.10.1994</i>	<i>Për mbrojtjen e pasurisë kulturore të luajtshme dhe të paluajtshme....</i>	<i>692</i>
<i>Ligj nr.7868</i> <i>datë 12.10.1994</i>	<i>Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr.7619, datë 12.10.1992 "Për inspektoratin e kontrollit të përdorimit të energjisë elektrike".....</i>	<i>698</i>
<i>Ligj nr.7869</i> <i>datë 12.10.1994</i>	<i>Për disa ndryshime në ligjin nr.7804, datë 10.3.1994 "Për dhomat e tregtisë dhe të industrisë".....</i>	<i>699</i>
<i>Ligj nr.7870</i> <i>datë 13.10.1994</i>	<i>Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë.....</i>	<i>700</i>
	<i>Vendim nr.6 i Gjykatës Kushtetuese.....</i>	<i>712</i>
	<i>Rregullore për dhënie e licensave për të vepruar si bankë në Republikën e Shqipërisë.....</i>	<i>718</i>

L I G J

Nr.7864, datë 29.9.1994

PËR KRYQIN E KUQ SHQIPTAR

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese",

KUVENDI POPULLOR I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I :

Neni 1

Kryqi i Kuq Shqiptar është një shoqatë humanitare vullnetare që e ushtron veprimtarinë në mënyrë të pavarur, në bazë të parimeve themelore të lëvizjes ndërkombëtare humanitare të Kryqit të Kuq, Gjysmëhënës së Kuqe dhe të konventave të Gjenevës të 12 gushtit 1949, ratifikuar nga Republika e Shqipërisë më 27 maj 1957, si dhe protokolleve shtesë të 10 qershorit 1977, të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë më 16 qershor 1993. Ai është ndihmës i organeve të pushtetit për çështjet humanitare në mbarë vendin.

Neni 2

Kryqi i Kuq Shqiptar, në gjithë veprimtarinë e tij, udhëhiqet nga parimet themelore të Lëvizjes së Kryqit të Kuq që janë humanizmi, neutraliteti, paanësia, pavarësia, vullnetarizmi, uniteti dhe universaliteti e që pajtohen me politikën e shtetit shqiptar për Kryqin e Kuq.

Neni 3

Kryqi i Kuq Shqiptar bën pjesë në lëvizjen ndërkombëtare të Kryqit të Kuq dhe

Gjysmehënës së Kuqe, si dhe është anëtar i Federatës Ndërkombëtare të Shoqatave të Kryqit të Kuq dhe Gjysmehënës së Kuqe.

Neni 4

Kryqi i Kuq Shqiptar e ushtron veprimtarinë e tij në bazë të statutit që vendoset nga asambleja e përgjithshme e tij. Ky statut miratohet nga Kryetari i Këshillit të Ministrave.

Neni 5

Kryqi i Kuq Shqiptar gëzon të drejtën e përdorimit të emblemës në përputhje me konventat e Gjenevës të 10 gushtit 1949 dhe protokollet shtesë të 10 qershorit 1977. Mënyra e përdorimit të saj rregullohet me ligj.

Neni 6

Kryqi i Kuq Shqiptar është person juridik. Ai mund ta ushrojë veprimtarinë ekonomike për të siguruar burimet financiare për përballimin e veprimtarive të tij humanitare.

Neni 7

Për programe të veçanta Këshilli i Ministrave mund të mbështetë veprimtaritë humanitare të Kryqit të Kuq me fonde buxhetore.

Neni 8

Kryqi i Kuq Shqiptar pranon kontribute të pakufizuara në çdo formë nga individë, persona fizikë e juridikë shqiptarë ose të huaj dhe organizon mbledhjen e tyre brenda vendit.

Neni 9

Kryqi i Kuq Shqiptar përjashtohet nga pagimi i çdo lloj tatimi a takse.

Neni 10

Dekreti nr.2254, datë 30.4.1956, dhe nr.4112, datë 7.3.1966, si dhe çdo dispozitë tjetër që bie në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohen.

Neni 11

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr. 945, datë 17.10.1994 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Sali Berisha**